



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:230468
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05731513

K.DH.SH.II.nr.1451/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “MC Food” ShPK, me seli në Lipjan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Azemi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.459/2022 të datës 11.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë e datës 10.10.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.459/2022 të datës 11.09.2023, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë me aktgjykimin e atakuar KF.nr.459/2022 të datës 11.09.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “MC Food” ShPK, me seli në Lipjan. Në pikën II të dispozitivit është anuluar aktvendimi nr.01.3.2.2/14774 i datës 15.09.2021 në Prishtinë. Nën pikën III. Mbetet në fuqi autorizimi për magazinim doganor me

numër reference EH037 për importin e mallrave në regjimin pezullues IM7 për subjektin juridik MC Food ShPK me numër unik identifikues 810545535. Nën pikën IV. secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura Dogana e Kosovës për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovoj ankesën në tërësi si të bazuar me ligj, të prish aktgjykimi KF.nr.459/2022 datë 11.09.2023 si të pa bazuar me ligj, të refuzon padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe ta lë në fuqi vendimin e kontestuar si të ligjshëm ose t'ia kthej lëndës Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditësi me të cilin ka propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës, e paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal i identifikuar si KF.nr.459/2022 datë 11.09.2023 si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal i identifikuar si KF.nr.459/2022 datë 11.09.2023.

Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa-bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështjet Administrative - Divizioni Fiskal, me datën 14.10.2021, ka paraqitur padi për anulimin e vendimit -aktit administrativ të Doganës së Kosovë në Prishtinë nr.01.3.2.2/14774 të datës 15.09.2021 me të cilin vendim i është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë për rishqyrtim të aktvendimit nr. 04.1.5-2021-775 të datës 14.07.2021 të lëshuar nga

Sektorit për Procedura dhe Autorizime. Dhe është lënë në fuqi aktvendimi numër 04.1.5-2021-775 të datës 14.07.2021 i lëshuar nga Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve.

Dhoma e Shkallës së Parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, me aktgjykimin KF.nr.459/2022 të datës 11.09.2023 e aprovon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit (si në dispozitiv të këtij aktgjykimit) anulon vendimin kontestues të paditurës dhe lë në fuqi autorizimin për magazinim doganor me numër reference ËH037 për importin e mallrave në regjimin pezullues IM7 për subjektin juridik MC Food ShPK me numër unik identifikues 810545535. Në arsyetim të aktgjykimit ndër tjerash ka konstatuar se: gjykata konstaton se nga interpretimi i dispozitës ligjore nga neni 15 par .2 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, gjykata konstaton se e paditura ka pasur të drejtë ta revokoj autorizimin e dhënë të këtij paditësit vetëm atëherë kur i njëjti dështon në përmbushjen e obligimeve që lindin nga vendimi-autorizimi në fjalë, pra kjo normë ka kuptimin e tillë që njëherit jepet autorizimi për depo doganore të tipit D, gjithmonë duke u bazuar në kurse dhe atë sipas kushteve të përcaktuara në nenet 103 deri 117 të KDA-së, lidhur me nenet 300 deri 310 të UA 11/2009, dhe vetëm atëherë nëse personi të cilin i është dhënë ky autorizim dështon në përmbushjen e obligimeve që lindin nga i njëjti, Dogana mund të marr veprime drejtë revokimit të të njëjtit, dhe jo si kurse në rastin konkret kur vet e paditura nuk ka konstatuar asnjë fakt që lidhet me dështimin e përmbushjes së kushteve sipas autorizimit ËH037 nga këtij paditësi, por mjaftohet me faktin e thirrjes në informata të disponueshme lidhur me rastin, informata këto që lidhen me çështje penale me dërgesën R-34877, dhe jo me kushtet e përcaktuara me autorizimin ËH037. Gjykata ka gjetur se e paditura në vendimin e saj nuk ka theksuar asnjë dispozitë ligjore në kuptim të asaj se njëra ose dy nga to ose të gjitha së bashku janë shkelur nga bartësi i autorizimit ËH037, për të mundur të vërtetohet përgjegjësia e bartësit të autorizimit në raport me mundësinë eventuale të revokimit të autorizimit. Gjykata ka elaboruar bazën ligjore që i referohet aranzhimeve doganore sipas regjimeve pezulluese dhe ka gjetur se për të paditurën autorizimi për depo doganore i tipit D në kuptim të procedurave doganore dhe realizimit mbikqyrës doganor nuk ka asnjë efekt negativ, përkundrazi rastet sikurse ky i paditësit për Doganën nënkuptojnë filtër të dyfishtë në kuptim të ushtrimit të mbikëqyrjes doganore, një me rastine procedimit të deklaratës doganore IM7 e cila deklaratë varësisht nga profili i përcaktuar sipas sektorit të analizës së rrezikut pranë të paditurës, kalon në kanalet e ekzaminimit në Doganë sikurse çdo deklaratë tjetër IM4, vetëm se në këtë rast për dalim nga deklaratat IM4, kur malli menjëherë pas përfundimit të procedurave doganore del në qarkullim të lirë e me këtë edhe del nga mbikëqyrja doganore, malli që futet në IM7 edhe më

tutje mbetet nën mbikëqyrje doganore dhe Dogana në çdo kohë ka qasje në këto dërgesa dhe mund të ushtroj kontroll shtesë. Gjykata vlerëson edhe faktin se në rastin konkret meqë këtu paditësi nuk ka pasur ndalese në ushtrimin e aktivitetit të tij biznesor sipas aktiviteteve të përshkruara me regjistrimit të biznesit në ARBK, nuk ka pasur ndalesë në importe të mallrave, nuk ka pasur konstatim nga Dogana se ka dështim në përmbushje të kushteve të specifikuara sipas autorizimit ËH037, atëherë i njëjti mund të operoj edhe me depo Doganore, përderisa kjo për paditësin ka vetëm efekt ekonomik-financiar në kuptim të mos kreditimit të taksave deri në shkarkim të deklaratave IM7 me deklaratat IM4 ose EX3, ndërsa për të paditurën nuk ka asnjë efekt negativ por vetëm mundësi më shumë në ushtrimin e mbikëqyrjes doganore në raport me mallrat nën regjimin pezullues IM7. Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi dhe në seancë gjyqësore, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Pala Paditëse konstatimet siç u theksuan edhe më lartë i ka bazuar në dokumente të besueshme e të cilat janë të administruara si prova nga gjykata dhe të cilat nuk ka mundur ti kundërshtoj e paditura me ndonjë provë materiale. Andaj gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par 2 pika 2.2 të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenin 46 par.2 lidhur me nenin 44 p[ar.1 të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon vlerësimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit”* e as nenit 194 të LPK -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as nga neni 38 të LKA -së, po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës administrative e as me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Si rezultat i kësaj, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se: konstatimi i gabuar i gjendjes faktike është se gjykata e shkallës së parë nuk merr parasysh faktin se bartësi i autorizimit në këtë rast subjekti juridik “MC Food” Shpk – Lipjan i cili si subjekt juridik ka vazhduar ta ushtroj afarizmin tregtar duke realizuar importe të mallrave dhe pas ndodhjes së rastit me datë 15.05.2021, sipas deklarimeve të palës paditëse në seancë “megjithatë edhe pas dërgesës së datës 15.05.2021 paditësi vazhdon me ushtrimin e të gjitha veprimtarive për të cilat është regjistruar në ARBK dhe ka pasur importe të vazhdueshme të mallit dhe e vetmja pasojë e këtij rasti është revokimi i autorizimit për taksa të pezulluara e i cili autorizim ka vetëm impakt financiar për këtu paditësin dhe ky autorizim nuk ka pasojë për palën e paditur, deklarim ky i cili nuk është kundërshtuar nga përfaqësuesja e palës së paditur, këtë konstatim e paditura e kundërshton pasi që paditësi nuk gëzon një reputacion të mirë dhe për të është duke u zhvilluar procedura penale. Gjykatë e Shkallës së Dytë, vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe Dhoma e Shkallës së Parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1451/23, me datë 24.05.2024

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**